

CV

Enver Buçaj - është Prof. Ass. Dr. në Universitetin e Prizrenit Fakulteti Juridik. Aktualisht punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, diplomat në Ambasaden e Kosovës në Mal të Zi, ndërsa e ka ushtruar këtë post edhe për një mandat tjetër (2014-2016), në Ambasaden e Republikës së Kosovës në Mbretërin e Bashkuar të Suedisë e cila ka mbuluar Finlanden, Norvegjin, Estonin, Islanden, Letonin dhe Lituani.

Në të kaluarën Buçaj ka shërbyer Këshilltar për Arsim të Lartë në Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2008-2010), si dhe Drejtor Akademik Themelues në Universitetin Publik të Prizrenit (2009-2011).

Gjatë periudhës (2000-2006), ka udhëhequr në cilësinë e Menaxherit të Lartë Programin Finlandez-UNHCHR i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës –Grupi Konsulent Finlandez, në përkrahjen e Institucioneve të Kosovës. Ndërsa gjatë vitit (2006-2007 dhe 2014) ka punuar në Bashkimin Evropian në Programin për fuqizimin e kapaciteteve Kosovare në parandalimin e krimeve financiare, shpërlarjes së parave, korrupsionit dhe terrorizmit, Programi i Bashkësive Evropiane i mbështetur nga AER-i.

Gjatë periudhës (1995-1996) ka qenë Asistent hulumtues të Profesori i së Drejtës Ndërkombëtare Prof. Dr. Martin Scheinin pranë Universiteti të Helsinkit, Finland. Ndërsa gjatë vitit (1995-2000) ka punuar përkthyes profesional Shqip-Finlandisht-Shqip në Kuvendin Komunal të Helsinkit në Qendren e Përkthimeve Profesionale.

Buçaj pas përfundimit të fakultetit dhe të magjistraturës ka mbaruar studimet e Doktoraturës për Drejtësi në Fakultetin Juridik duke ndjekur ligjërata në drejtimit e shkencave të së Drejtjes Penale. Ka studiuar në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Helsinkut në Finlandë.

Ai ka botuar punime shkencore në gjuhën angleze, finlandeze dhe shqipe për çështje të së drejtës penale me konkretisht në fushën e terrorizmit në përgjithësi dhe të terrorizmit kompjuterik në veçanti.

- Ka botuar librin *Terrorizmi Kompjuterik* (2015).
- *Autor i Librit "E drejta e Trashëgimisë në Kosovë" me Prof. Dr. Juliana Latifi. Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik;*
- *Bashkëpërkthyes i Mendimeve të Badinterit;*
- *Korrektor i Librit "Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut" të autorit Gudmundur Alfredson/ Përkthimi në gjuhën shqipe;*
- *Korrektor i Librit "Kodet e sjelljes në zgjedhje" nga Autori Guy S. Goodvin-Gill/ përkthimi në gjuhën shqipe;*
- *Korrektor i librit "Të drejtat e njeriut në Administratën e Drejtësisë", doracak për gjykatësit, prokuroret dhe avokatet / përkthim i kombeve të bashkuara versioni në gjuhën shqipe;*
- *Përkthyes dhe korrektor i librit "Jurisprudenca e Ligjit të të drejtave të njeriut një qasje Krahasimore" të autorit Martin Schainin, Allan Rosas dhe Theodor Orlin, versioni në gjuhën shqipe*

Gjithashtu ka mbajtur ligjërata të ndryshme në disa universitete, si në Universitetin e Helsinkit, Finland, Universitetin e Upsales, Universitetin e Lundit, Universitetin e Gothenborgut në Suedi etj.

Pjesëmarrës në konferenca shkencore dhe seminare në Finland, Suedi, Austri, Norvegji, Portugali, Estoni, Irland, Gjermani, Itali etj

Flet dhe shkruan mirë gjuhën angleze, finlandeze dhe serbo-kroatishte dhe ka njohuri bazike në gjuhën suedeze.